



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosova
Komuna e Novobërdës
Opština Novo Brdo - Municipality of Novo Brdo



KUVENDI KOMUNAL-SKUPSTINA OPSTINE- MUNICIPAL ASSEMBLY

PROCESVERBAL

Nga mbledhja e pestë e rregulltë e Kuvendit të Komunës së Novobërdës e mbajtur më datë 30.05.2019, duke filluar në orën 10:00.

Në mbledhje kanë marrë pjesë: Kryesuesi Nebojsa Arsic, zv.Kryesuesi Ramush Mehmeti, Nënkryetari për Komunitete Bajrush Ymeri, anëtarët e Kuvendit: Ivica Cenic, Mirjana Simijonovic, Jorgovanka Filic, Dragana Dimic, Abdyl Gashi, Negovan Jovanovic, Milica Jovanovic, Selatin Nuhiu, Dobrivoje Djordjevic, Predrag Stojkovic, Zymer Zymeri, Jahi Zeqiri, Drejtori i Urbanizimit Bojan Peric, Drejtori i Administrates Driton Abdyl, D.SH.P Shefkije Mehmeti, përfaqësuesi i OSBE-es, zyrtar dhe qytetarë.

Kryesuesi i Kuvendit Nebojsa Arsic pasi përshendeti të pranishmit tha: para se të fillojm me mbledhjen duhet konstatuar korumin prezent janë të gjithë antarët e Kuvendit dhe kemi korum për punë dhe vendimarrje dhe po fillojm mbledhjen me këtë:

Rend dite

1. Aprovimi i procesverbalit nga mbledhja e kaluar e K.K-së;
2. Raportimi i Komisionit për dhënjen e tokës Komunale në Shfrytëzim;
3. Aprovimi i planit aksional të Komunës për efiqenc të energjisë (PAKEE);
4. Aprovimi i propozimit për percaktimin e automjetve të vjetra Komunale që janë jashtë perdorimit;
5. Informat rreth mos kyçjes të të gjithë ujësjellësve egzistues në Komunën e Novobërdës në memorandumun e nënshkruar në mes të Komunës së Novobërdës dhe Kompanis Regjionale Hidromorava;
6. Informat rreth mos mirëmbajtjes dhe funksionalizimit të të gjithë sitemeve të ndriqimit publik egzistues në Komunën e Novobërdës;
7. Të ndryshme.

Kryesuesi i pyeti të pranishmit se a pajtohen me këtë rend dite apo keni ndonjë propozim?.

Nënkryetari i Komunës Bajrush Ymeri pasi përshendeti të pranishmit tha: para se të aprovohet rendi i ditës unë kam vërejtje rreth dy pikave të rendit të ditës të mbledhjes së kaluar të cilat i kemi diskutuar bashkarisht këtu, njëra pikë në mungesë të propozuesit ka qena pika e tretë për formimin e komisionit për dhenjë në qiar afatshkurtër vendgjuesisë, në mungesë të propozuesit është terheq kjo pikë dhe sipas asaj që shkruan në procesverbal thuhet se kjo pikë shtyhet për mbledhjen e ardhshme të KK, pika tjetër ka qenë aprovimi i vendimit të KKSB-së, pas diskutimeve që i kemi bërë kemi kërkuar kohë dhe kemi thënë ashtu shkrun edhe në procesverbal që të shtyhet për mbledhjen e ardhshme, unë mendoj se në momentin që dy pika votohen të shtyhen për mbledhjen e ardhshme të Kuvendit Komunal nuk është duhur të shkojnë në KPF por drejperdrejt të vin në Kuvend, andaj mendoj se keni bërë shkelje duke i

Procesverbali i Kuvendit

derguar në KPF e ti stoponi për Kuvend, të dy pikat janë të rëndësishme, dhënja e gjuetis në shfrytëzim duhet të ipet pasi që është e përcaktuar më ligj, formimi i KKSB-së është i nevojshëm të formohet pasi që shumë herë po diskutojm për qështje të sigurisë, ju faleminderit.

Kryesusi tha: sa i perket këtyre dy pikave kemi thënë që të shtyhen për ndonjë nga mbledhjet e ardhshme, këto pika jan propozuar në KPF por nuk kan kaluar.

Bajrush Ymeri tha: në procesverbalin në gjuhen shqipe për këto pika shkrun se me 13 vota për dhe 1 kunder dhe 1 apstenim është shtyer për mbledhjen e ardhshme kjo pikë, pra pika e tret e rendit të ditës, po ashtu edhe pika e pestë e rendit të ditës thuhet se me 9 vota për 4 kunder shtyhet për mbledhjen e ardhshme kjo pikë e rendit të ditës, prandaj unë mendoj se nese një herë një pikë kalon ën KPF nuk ka nevoj që të shkoj perseri, ju faleminderit.

Zv.Kryesuesi Ramush Mehmeti pasi pershendeti të pranishmit tha: po nderlidhem me diskutimin e nënkryetarit, kur të vjen pika e procesverbalit do të diskutojm pasi që ka vërejtje, sa i perket pikes për terheqjen e pikës së KKSB-së unë kam qenë ai propozues perseri qendroj pas asaj kërkesë, duke e pasur parasysh se komiteti i mëhershëm nuk është paguar, andaj ky komitete nuk do të formohet deri sa egzekutivi nuk raporton se si do ti paguaj këta antarë dhe se si do tju kthej borgjet antarve të mandatit të kaluar, ju faleminderit.

Pasi nuk pati diskutime tjera rendi i ditës u aprovua me 9 vota për 6 kunder (Predrag Stojkovic, Jorgovanka Filic, Negovan Jovanovic, Xhejlane Behluli, Zymer Zymeri, Jahi Zeqiri) nga antarët prezent të Kuvendit.

Pika e parë: Aprovimi i procesverbalit nga mbledhja e kaluar e K.K;

Kryesuesi e hapi diskutimin për këtë pikë.

Ramush Mehmeti tha: unë edhe më heret e cekta se në procesverbalin e fundit dhe të parafundit ka pasur shumë gabime drejtshkrimore, ka pasur gabime edhe në kuptim të fjales, andaj kërkoj nga asistentja e Kuvendit e di që ska qenë në mbledhjen e fundit por të pakten të kontrollohet dhe permirësohet ekstrakti i procesverbalit, nuk ka nevoj të shkruhet çdo detaj në procesverbal por të jetë kuptimi i fjalëve, mos të keqkuptohemi pasi që ne kemi thënë të shtyhet për seanca tjera ndërsa aty shkrun të shtyhet në mbledhjen e ardhshme, të mos ket dallime në mes të antarëve të Kuvendit por secili atë që e propozon ti shkruhet, ju faleminderit.

Selatin Nuhiu pasi pershendeti të pranishmit tha: sa i perket procesverbalit ne dy tri mbledhjet e fundit kemi pasur mjaft vërejtje sa i perket fjalimit tim, pasi nuk e ka shkruar të gjithë fjalimin tim dhe tjera her procesmbajtja e procesverbalit duhet ti shkruaj të gjithë për pikë e presje ashtu si kam thënë, ka pakjartësi në drejshkrim, p.sh në një fjalim timin permendet Fadil Llapashtica, unë në Kuvend asnjëher se kam permendur Fadil Llapashtica por Fadil Gerbeshin.

Pasi nuk pat diskutime tjera rreth procesverbalit, procesverbali u aprovua me 14 vota për dhe një nuk ka votuar nga antarët prezent të Kuvendit.

Pika e dytë : Raportimi i Komisionit për dhënjen e tokës Komunale në Shfrytëzim;

Për këtë pikë Kryesusi ja dha fjalen Drejtorit të Urbanizimit dhe Katsatrit Boajn Peric.

Bojan Peric pasi pershendeti të pranishmit tha: para fillimit të takimit ju kam dorzuar materialin për kontratat e nënshkruara nga komisioni që ka punuar në mandatin e kaluar, sa i perket komisionit këto ditë na kanë derguar ligjin e ri për dhënje të pronës Komunale në shfytëzim dhe në bazë të këtij ligji komisioni duhet me qenë në përbërje prej 5 antarëve 2 antarë nga ekzekutivi, 2 nga kuvendi dhe 1 nga shoqëria civile, pasi që Shefkije Mehmeti ka qenë kryesuese e komisionit të mandatit të kaluar ja kaloj fjalen për më shumë informata, ju faleminderit.

Shefkije Mehmeti pasi pershendeti të pranishmit tha: po ju informoj rreth komisionit të mëhershëm i cili ka punuar për dhenjen e tokës Komunale në shfytëzim. Më ligjin e mëhershëm kemi qenë pjesë e komisionit shtatë antarë por me ligjin e ri komisioni duhet me qenë në përbërje prej shtatë antarë. Në mandatin e kaluar kryesuese e komisionit kam qenë unë dhe ne kemi punuar sipas ligjit, kemi bërë hapjen sipas ligjit në ankand publik 30 ditë ku qyettarët kan aplikuar per marrje të pronës komunale në

shfytëzim, kemi raportuar në Kuvend se si i kan ofruar çmimet ku në bazë të rregullores së mëhershme çmimi ka qen shumë i lartë duke marrë parasysh ndryshimin e rregullores tash. Pronarët të cilet e kanë marrë pronen Komunale në shfrytëzim e keni listen para jush por disa nuk e kan permbushur kontratat e nënshkruara dhe këtyre që nuk i kan plotësuar kushtet ju kemi derguar vërtjete me shkrim secilit që ta bëjnë pagesen.

Kryesuesi e hapi diskutimin për këtë pikë.

Ramush Mehmeti tha: te lista numer 4 Remzi Sylva ati zotnie nuk ju ka lejuar ta shfrytëzoj pronen edhe pse e ka nënshkruar kontraten çka keni vepruar në këtë rast?.

Shefkije Mehmeti tha: nuk i është lejuar të shfrytëzohet prona prej qytetarëve, ne kemi pasur takime me qytetar më Kryetarin e Komunës me Avokatin e Popullit dhe me Polici por ne nuk po mundemi qytetarët mi ndalu edhe pse çdo herë ka qenë i pergjeshmë në pages edhe pse nuk ka mujtur që ta shfrytëzoj prej qytetarëve të vet.

Selatin Nuhiu tha: unë si antarë i komisionit për dhënje të tokës Komunale në shfytëzim jam zgjedh në vitin e kaluar dhe në atë komision vetem një her jena taku dhe më ska pas asnjë herë asnjë mledhje, në raport i kemi vetem pronat të cilat bëjnë pagesa, nese ka mundësi me pa edhe listen e persoanve të tjer të cilët nuk janë duke paguar.

Bojan Peric tha: besoj se kolegeja u sqaru në lidhje më këtë për masat që janë marrë ndaj atyre që nuk kanë paguar, nuk ka pasur kërkesa për dhënjë të tokës Komunale në shfytëzim për këtë arsye nuk jemi takuar.

Xhejlane Behluli pasi pershendeti të pranishmit tha: po me vjen çudi me Shefkijen pasi që është kryesuese e komisionit të kaluar, ne e kemi formuar një komision nuk funksionon kjo raporton për komisionin e mandatit të kaluar, ky raport është për vitet 2015-2016 por për vitet tjera nuk po shoh ndonjë raport, atëher pasi paska ardhur ligji i ri për me formu komisionin prej pesë antarëve e formojm kemi shkuar si kemi shkuar deri sot po të permirësohemi ti zgjedhmi dhe të punojm ashtu si është rendi dhe ligji, ju faleminderit.

Mirjana Simijonovic pasi pershendeti të pranishmit tha: i kam disa vërejtje rreth këtij raporti pasi që ky raport na ka ardhur vetem 5min para mbledhjes së Kuvendit dhe është vetem në gjuhen shqipe, ju kisha lut që mos me ndodh më kjo pasi që çdo dokument duhet të jetë në të dy gjuhët, gjithashtu ky raport ka shumë plusa, minusa nuk e kuptoj, Sercan Mitrovic ka paguar nuk ka paguar nuk e kuptoj mirë, komisionet duhet të jenë më të pergjegjshme dhe të punojnë, ju faleminderit.

Dobrivoje Djordjevic pasi pershendeti të pranishmit tha: nuk e kam të qartë çmimin dhe disa hektar janë paguar disa nuk janë paguar, ndoshta munden me qen gabim, ju faleminderit.

Shefkije Mehmeti tha: komisioni i mëhershëm është formuar prej Kuvendit dhe ka raportuar çdo herë në Kuvend por me zgjedhjen e komisionit të ri ne nuk kemi mandat, kur është zgjedh komisioni i ri kam marrë pjesë në takim ja kam prezantu se si duhet të fillojnë, sa i perket materialit që ka ardh shqip ashtu se e kam pas në kompjuter shqip nuk e kemi derguar per perkthim ndersa sa i perket pagesave kur e kemi dhënë në fillim ka qenë rregullorja e aprovuar në Kuvend e cila e ka caktuar çmimin na bazë të klases me pastaj rregullorja është ndryshu dhe është çmimi më i ultë.

Dobrivoje Djordjevic tha: e kam një propozim që këto kontrata të shkojn për verifikim në Ministri.

Abdyl Gashi pasi pershendeti të pranishmit tha: edhe Drejtori e permendi se me vones na ka arritur ky raport i cili është shumë i mangët, komisioni është formuar që një vit e me teper dhe është duhur të jetë një raport më i specifikuar, mendoj se ka më shumë prona publike që shfrytëzohen se sa janë në këtë listë, ndoshta ka edhe prona që uzorpohe dhe nuk i japin llogari askujt, nuk e di a është parregullësi apo neglizhenc e Komunës por prona Komunale duhet të konsiderohet më e shtrenjt se prona private. Pervec PTK dhe dy apo tre persona tjer nuk po e shoh që paguajn pronë publike. E kam një pyetje konkrete se cilat janë veprimet e juaja për ta permirësuar këtë gjendje në lidhje me këto prona pasi që kemi shumë prona të uzorpume, shumë prona publike që shfrytëzohen e nuk paguajnë dhe që keqperdoren prej njerzve të pandergjegjshëm, ju faleminderit.

Shefkije Mehmeti tha: sa i perket pronave që janë dhënë në shfrytëzim këto janë që janë dhënë prej Kuvendit Komunal ndërsa pronat e pylltarisë i jep Ministria e Bujqësisë në shfrytëzim.

Abdyl Gashi tha: te kjo qeveri ka shumë mangësi dhe qytetarët po i vuajn pasojat e juaja, nese nje drejtori e konsideron të veçant si Drejtorin e Bujqësisë prej urbanizimit këto janë të lidhta njëra me tjetren.

Kryesuesi tha: keni derguar raportin për dhënje të tokës Komunale në shfrytëzim, u permde ligji i ri për dhënje të tokës Komunale në shfrytëzim ku sipas këtij ligji në nenin 17 thuhet se komisioni përbëhet prej 5 antarëve, 2 antarë nga Kuvendi, 2 nga ekzekutivi dhe 1 nga sektori civil. Ne këtë komisioni do ta formojm në ndonjë prej mbledhjeve të ardhshme pasi që duhet ti kemi edhe dy propozime nga ekzekutivi.

Xhejlane Behlili tha: mendoj se perpara se të formohet komisioni i ri duhet të anulohet vendimi i mehershëm.

Pasi nuk pati diskutime tjera anulohet njëzëri nga të gjithë antarët prezent të Kuvendit Komunal vendimi për dhënje të tokës Komunale në shfrytëzim dhe mirret ky:

V E N D I M

Anulohet vendimi i datës 07.05.2018, me nr. protokolit 01-209.

Ramush Mehmeti tha: e kisha lut Drejtorin e Urbanizimit që ta parasheh mundësin edhe formimin e komisionit për ankesa, ne harmoni me ligjin dhe rregulloret të formohet edhe ky komision në sencat e radhes.

Pika e tretë: Aprovimi i planit aksional të Komunes për efqenc të energjisë (PAKEE);

Për këtë pikë Kryesusi ja dha fjalen D.SH.P Shefkije Mehmeti.

Shefkije Mehmeti tha: materialin e keni marrë të gjithë për këtë projekt të mbështetur nga BE. Këtë plan e kanë pregaditur BE për të gjitha Komunat, detyrë e Komunës ka qenë vetem ti sigurojm informatat dhe ta bëjmë perkthimin. Ky plan është shumë i mirë për Komunën tonë dhe të gjitha Komunat e kanë aprovuar këtë plan vetem Komuna jonë e Ranillukit dhe e Parteshit nuk e kanë aprovuar ende, nese keni ndonjë pyetje, urdhëroni.

Kryesuesi e hapi diskutimin për këtë pikë.

Ramush Mehmeti tha: nese këtë plan e kanë bërë BE atëher nuk besoj se duhet ta aprovoj Kuvendi Komunal, planet e BE i aprovon BE, por nese është plan i Kuvendit Komunal kisha bërë pyetje prej prezantueses a është aprovuar prej Ministrisë pasi që çdo plan strategjik duhet të merr pelqimin prej Ministrisë, andaj kërkoj që ky olan të shtyhet per seancen e ardhshme kur të kemi pelqimin prej Ministrisë.

Shefkije Mehmeti tha: ne kemi pasur takim me BE dhe personi pergjegjës që është për këto plane ka thënë se njëher duhet ti aprovoj Kuvendi Komunal e pastaj të dergohen në Ministri për aprovim, kështu kanë thënë ata pasi që ky plan është për Komunën tonë.

Ramush Mehmeti tha: në këtë plan më së shumti ka punuar Sami Vllasaliu dhe ai kishte më dhënë raport më mirë për këtë plan, ju vetem e keni marrë të gatshëm dhe nuk jeni duke raportuar ashtu siç duhet për këtë arsye kur të mirret pelqimi prej Ministris jemi dakord që ta aprovoj, nuk e keni prezntuar ashtu siç duhet dhe mendoj se nuk duhet të aprovohet.

Shefkije Mehmeti tha: nuk është problem për mu hiq asgje mos aprovon.

Kryesuesi tha: e kam një pyetje se cila Ministri duhet ta aprovoj këtë plan?

Ramush Mehmeti tha: ashtu si thash edhe më heret në këtë projekt më shumë ka punuar Sami Vllasaliu, i cili ka qenë një puntorë shumë aktiv, plani duhet të aprovohet nga Ministria e ambientit dhe Ministria e Efiqencave, unë kam marrë informata edhe më heret dhe më kanë thënë se a e ki pelqimin prej Ministrisë e pastaj të aprovohet në Kuvend.

Shefkije Mehmeti tha: unë nuk e kam marrë punën e tjer kujt pasi që Sami Vllasaliu e ka derguar të unë, Samia vetem jav ka derguar të dhënat, pasi që unë jam zyrtare e ambientit e ka derguar të unë dhe së pari duhet të aprovohet në Kuvend e pastaj të dergohet në Ministri.

Pasi nuk pati tjera diskutime Kryesuesi e hudhi në votim këtë pikë.

Procesverbali i Kuvendit

Me 6 vota për, 8 kunder (Nebojsa Arsic, Ramush Mehmeti, Abdyl Gashi, Selatin Nuhiu, Mirjana Simijonovic, Milica Jovanovic, Ivca Cenic, Dragana Dimic) dhe 1 apstenim nuk aprovohet plani aksional t Komunes për efqenc të energjisë.

Pika e katërt: Aprovimi i propozimit për percaktimin e automjeteve të vjetra Komunale që janë jashtë perdorimit;

Për këtë pikë Kryesuesi ja dha fjalen Drejtorit të Administartes Driton Abdylit.

Driton Abdyli pasi pershendeti të pranishmit tha: e kam dhënë vërtjtje edhe në KPF pasi që nuk është pika për percaktimin e automjeteve të vjetruara pasi në nuk kemi me percaktu sepse e kan percaktuar komisioni poer ne kemi me marrë vendim për shitje. Unë e kam formuar një komision në bazë të ligjit për vetqevirsje lokale, komisioni ka punuar dhe e ka sjell një raport që këto mjete nuk janë të perdorshme, dhe unë kam ardhur sot në Kuvend që të marrmi vendim për shitje nese doni ju merrni vendimin nese jo nuk e marrim nuk shtë asgjë në interesin tim, nese keni ndonjë pyetje lidhur me diqka që nuk ka në material, ju faleminderit.

Kryesuesi e hapi diskutimin për këtë pikë.

Abdyl Gashi tha: me intereson ta dij se ku gjenden ato vetura?, sa vetura janë?, sa vetura janë të vjetra jashta funksionit?, sa janë të reja në funksion?, ka drejtori që nuk ka vetur, është një keqmenaxhim i krejt Komunës, ne nuk munde të votojm që ti shesim pasi se dim për cilat veturapo bëhet fjal.

Driton Abdyli tha: ashtu siç ju thash unë e kam formuar një komision, ai komision ka punuar dhe më ka sjell raport, atë raport që e keni ju e kam edhe unë, gjithsej janë 29 vetura edhe me shenime nga qendra e regjistrimit të automjeteve, këto vetura komisioni i ka konstatuar si të pa perdorshme.

Zymer Zymeri pasi pershendeti të pranishmit tha: shumë më heret është duhur që të largohen këto vetura, ku të shkojsh në garazha i ki veturat e Komunës, më mirë është që të gjitha veturat të shiten dhe të mirren vetura me qira sikurse ne Ministri, më shumë kushtojn prishjet e veturava se sa mi pagu me qira, më mirë është që Komuna ti ket 5-6 vetura dhe vetem derivatet i mbulon Komuna.

Jahi Zeqiri pasi pershendeti të pranishmit tha: po kyçem pak ne lidhje me automjetet pasi që e di pak a shumë se si është gjendja e tyre, mirë është me u mirrë më serioz me këtë punë, realisht gjendja e tyre është që të largohen të gjitha këto automjete nga komunikacioni.

Ramush Mehmeti tha: më duket se në senacen e tretë të Kuvendit unë kam thënë një gjë të tillë, si plan i hartuar prej Drejtorisë është i hartuar në mënyrë profesionale por kisha kërkua nga Drejtori mundësishtë që në konsultim me zyren e prokurimit pasi që qysh e di unë së pari duhet të formohet një komision për shitjen e veturave, ta dim gjendjen reale se sa vetura i kemi dhe sa po mundemi ti bëjmë më këtë shitje, komisionin e ka formuar Drejtori dhe ka vlerësuar gjendjen por ai komision të konsultohet me zyren e prokurimit në mënyr që mos të bëjm ndonjë gabim, dhe ne senacen e radhet të marrim vendim ashtu si duhet e mos të marrim vendim vetem ti shesim por si do ti shesim dhe kujt do tja shesim, ju faleminderit.

Fatos Ahmeti zyrtar në zyren e prokurimit pasi pershendeti të pranishmit tha: realisht zyrja e prokurimit nuk cakton leje por ai komision i cili është formur ai duhet ti zhvlersoj, ne i kryejm vetem punët teknike, të gjithë institucionet shitjen e kryejn permes shtepisë së ankandeve ne bazë të një rregullore të nënshkruar nga Ministria, kusht që kishte qenë më mirë të mirren ata pasi që çmimi fillestar qe ipet nuk do të thotë se shitet me atë çmim, andaj propozoj qe shitja të shkoj permes shtepisë së ankandeve, ju faleminderit.

Abdyl Gashi tha: komisioni e ka bërë vlersimin e atyre automjeteve, për një vetur shkruan se është i paregjistruar ku është keqmenaxhim i Komunës që nuk ka arrit me i regjistru, janë gomat e hargjuara, bateria e hargjuar dhe defekt në motorr i cili mundet me qenë diqka kurgji hiq ne vler prej 5-6€, nuk e di se çfare komisioni pasi që shumica është vetem shabllon, shumica është bateri e hargjuar, goma të hargjuara.

Driton Abdyl tha: qështja e komisionit është ashtu si është dhe a është profesionale apo jo ashtu e ka bërë vlersimin, ne për pronen tonë kemi bërë një komision dhe është e drejt e juaja nese doni që ta caktoni edhe një komision, por për ta bërë vlersimin se sa është vlera në treg e tyre në mënyr ligjore po foli është sistemi i kontabilitetit i cili e cakton se kjo vetur i bënë kaq pare të gjithë e dim që nuk ka vetur deri në 10 vjet pasi

që për 5 vite zhvlersohet për 20%. Nese doni ju Kuvendi mundë të formoni komision në veti por nuk keni nevoj se skeni çka te vlersoni më shumë, zt.Gashi në momentin që vetura është e paregjistruar është i pa peperdorshëm, ne motorr ka defekt ai nuk ndezet nuk e din se çka ka, janë gjithësej 29 automjete, 11 jane për shitje nese doni i shesim si tja merr menja ju, une pastaj vetem i bëj kerkes zyres se prokurimit, per mu qysh tja merr menja ashtu veproni.

Pasi nuk pati tjera diskutime Kryesuesi e hudhi në votim këtë pikë.

Me 5 vota për, 8 kunder(Nebojsa Arsic, Ramush Mehmeti, Abdyl Gashi, Selatin Nuhiu, Mirjana Simijonovic, Dobrivoje Djordjevic, Ivca Cenic, Dragana Dimic) dhe 1 apstenim nuk aprovohet vendimi per shitjen e automjeteve të vjetra jashtë perdorimit.

Pika e pestë: Informat rreth mos kycjes te të gjithë ujësjellësve egzistues në Komunen e Novobërdës në memorandumun e nënshkruar në mes të Komunës së Novobërdës dhe Kompanis Regjionale Hidromorava;

Kryesusi për këtë pikë ja dha fjalën D.SH.P Shefkije Mehmeti.

Shefkije Mehmeti pasi pershendeti të pranishmit tha: ne d im që në vitin 2015 kemi pasur një marrëveshje të nënshkruar më Hidromoraven e cila ka pasur për obligim që së pari të bëj riparimin e disa ujësjellsave dhe pse nuk janë marrë të gjitha ujësjellsat pasi që ka shkuar me zona në fillim ka qenë zona 1, zona 2, pastaj zona 3, së pari kemi bërë marrëveshje me fshatin Makresh, Bostan, pastaj kanë vazhduar fshtart tjera, ka pas mu kyç edhe fshati Llabjan por te gjith e din procesin se si është aty edhe pse prona është Komunale pronari afer nuk po lejon me u shfrytëzu uji në javen e ardhshme do të nënshkruhen marrëveshja me fshatin Kufc, Novobërdë, Kala.

Kryesuesi e hapi diskutimin për këtë pikë.

Dobrivoje Djordjevic tha: në Stanishor nuk u permend asgjë për ujësjellësin, ka ardhur vetem deri të fabrika e jo në të gjithë fshatin, nuk e di a jeni të njoftuar ju apo Komuna, nuk e di se si ka ardhur ujësjellësi vetem për disa familje.

Shefkije Mehmeti tha: sa i perket fshatit Stanishor nuk ka qenë i parapar ne atë marrëveshje pasi që se pari duhet të bëhet rrjetëzimi e pastaj të nënshkruhet marrëveshja me Hidromoraven, sa i ujësjellësit që e kan pruar deri aty nuk jemi të njoftuar dhe duhet të bëhet kerkes e veqant pasi qe nuk është i kyçur në marrëveshje.

Dobrivoje Djordjevic tha: nese dikush tjter ka punuar diçka aty, Komuna duhet të merr ndonjë mas pasi që mundet të ketë shkelje ligjore.

Abdyl Gashi tha: është një marrëveshje që është nënshkruar prej disa nga perfaqësuesit e fshtrave, uroj të jetë ashtu sipas zones, mendoj se është një padrejtësi dhe një keqmenaxhim pasi që nuk ka as kontest gjyqësore as asgjë në lidhje me atë ujësjellës, është një ligështi një turp që po ndodh, ne ende nuk nuk po e dim cili është drejtori cili është pergjegjësi, secili thotë mu më kan thënë me raportu e nuk dihet se cili është personi pergjegjës, ju faleminderit.

Zymer Zymeri tha: problemi në Llabjan si është a jemi në të gjithë fshtrat së bashku, si ka mundësi që Pasjaki e ka nënshkruar e Llabjani ende jo, problemi në Llabjan duhet të zgjidhet, pronari e kish një kusht po ai kusht nuk ish i madhë pasi që Kryetari mundet ta zgjedh se bashku me Nenkryetarin e Komuniteteve dhe punëtorët që po rrin në barak gjatë gjithë dites a janë duke punuar diçka?.

Shefkije Mehmeti tha: sa i perket qështjes së fshatit Llabjan ne çdo her kemi pasur takim edhe me Nenkryetarin për Komunitete edhe me Kryetarin e Komunës, edhe pse gjykata e ka kthy pergjigjen në favor të Komunës ai pronari ka kerkuar kushte, kemi shkuar për ta bërë riparimin por nuk na ka lejuar, kemi shku edhe me punëtorët e zyres zvicrane por nuk na kanë leju as mu afriu te ujësjellësi.

Mirjana Simijonovic pasi pershendeti të pranishmit tha: në fshatin Koretishtë para disa ditëve janë ndrruar ujëmatësit por ende nuk funksion asgjë, a pritet deri sa të lidhen të gjitha fshatrat e të funksionoj apo kur qytetarët do të kenë ujë?.

Shefkije Mehmeti tha: në fshatin Koretisht është kyçur por ende nuk janë regjistruar të gjithë banorët.

Xhejlane Behluli tha: e kisha lut kolegun Abdyl Gashin pasi që jemi këtu të flasim për të gjithë Komunën e jo vetëm për Llabjanin perderisa ki vota edhe prej Pasjakit, sa i perket Hidromoraves ne mundë edhe të protestojmë pasi na neglizhojnë mundë të marrim edhe ndonjë iniciativ qytetare, por kur ta flasim ta përfshijm gjith Komunën perdirsa paguhemi prej taksapaguesve të gjithë qytetarëve të Komunës.

Abdyl Gashi tha: më vjen keq Xhejlane por ja spom kupton ose spo degjon mirë unë i permenda të gjitha fshatrat por Llabjani është rast specifik pasi që ka mbetur peng, sa i perket Pasjakit në bashkpunim me ty e kam propozuar një rrugë për në fshatin Pasjak ndërsa ti je detyruar me terhjek voten kunder dhe i bjen se unë më shumë se ti po interesohem për fshatin Pasjak.

Xhejlane Behluli tha: atë ditë nuk kam qenë kunder ju as kunder propozimeve të juaja për Pasjak, atë ditë kur është diskutuar për projekte ka fol edhe Nënkrystari i Komunës që është Kryetari i LDK ka fol për shumë projekte dhe ka thënë se kjo shumë nuk mundet me na mjaftu për këto projekte investues duhet me qenë shumë më e madhe e mjeteve se që ka qenë në buxhet, kur është hudh në votim ndoshta edhe për arsye të gjendjes sime shendetesore, ndoshta edhe perkthimi nuk është kuptuar mirë mirëpo unë kam menduar se po hyn në votim edhe projektet e propozuara nga Kryetari Bajrush Ymeri, mirëpo kur e kam kuptuar se është fjala vetëm për projekte të cilat ju i keni propozuar atëher unë e kam terhjek voten time pasi që është legjitime dhe është e drejta ime, ju falminderit.

Jahi Zeqiri tha: ju kisha lut të gjithëve mos me u mirrë me të kaluaren, ka 5-6 muaj që ka kaluar ajo ditë, secili e din se ka të drejt të drehjek ose mos të terhjek voten, mirë është me u mirrë me problemet që janë si p.sh ujësjellësi në Llabjan mirë kishe më qenë mu aktivizu nese ka probleme me pronarin nuk do të thotë se është vetëm një pronarë mundeni të hulumtoni të bëni një shpuarje tjer pasi që qytetarët kanë shumë nevoj për ujë, ju faleminderit.

Selatin Nuhiu tha: para 3-4 mbledhjeve e kam ngrit qështjen e ujit në Llabjan pasi që është konteksti vetëm me një individ, nese prona është e Komunës, Komuna duhet ti dal zot prones se vet dhe ne me punu për të miren e qytetarëve dhe sa më shpejt me aktivizu atë ujësjellës pasi që janë rreth 300 ekonomi familjare të cilat sot kanë shumë nevoj për ujë, por nese Komuna nuk mundet mi dal zot prones së vet atëher komuna duhet të bëjë një zgjidhje tjer.

Bajrush Ymeri tha: meqë pat shumë diskutime rreth kësaj qështje pasi që kam qenë në pozit të Kryetarit dhe tash të Nënkrystarit mendoj se kam pak njohuri rreth kësaj qështje andaj po e dha pak kontributin tim, besoj se nuk po bëhem i tepert, fakti se ka diskutime shumë tregon se ka problem në këtë drejtim, unë e di se çka kam hjek në mandatin tim me menaxhimin e këtyre ujësjellsave nga viti 2008-2013 natyrisht që numri i ujësjellsave për çdo vit është rrit pasi që ne kemi bërë investime në bazë të kerkesave të banorëve për të ndertuar ujësjellës të rinjë përveç atyre egzistues, problemi në Llabjan është se qështja e pronësisë qysh kur është ndertu nuk është zgjedh është bërë një marrëvshje atëher me pronarin që e ka fal një pjesë të tokës vetëm ku janë pompat por nuk është finalizu në gjykat me u bë e plotëfuqishme dhe me u bartë ajo hapsire si tokë Komunale për këtë arsye ne kem sot probleme, por nuk është vetëm të prona problemi pasi që ujësjellësi është nderpre nga KEK-u me 23,000€ pasi që nga viti 2008 kur është funksionalizu ujësjellësi asnjëher nuk është faturu asnjë fakturë, përnjëher ka ardh fatura prej KEK-ut e ka fatur gjendjen dhe ka ardh fatura me 23,000€, kjo shumë ka qen e paperballueshme që të paguhet si nga qytetarët ashtu edhe nga Komuna, prandaj është nderpre dhe që nga atëher jemi me probleme dhe problemi kryesor në këtë drejtim është kompania regjionale Hidromorava në Gjilanë pasi që vendimi i Qeverisë së Republikës së Kosovës me datë 08.06.2011 është se të gjithë ujësjellësit e Komunës së Novobërdës dhe të Komunave tjera ne regjion të Gjilanit të menaxhohen nga kompania regjionale Hidromorava dhe pse kalojnë 8 vite dhe nuk funksionalizohet kjo qështje nuk ekam besuar, unë kamë qenë edhe në Ministri të Zhvillimit Ekonomik atëher dhe më kanë thënë se merre këtë vendim dhe derkoja Drejtoreshes e cila ka qenë atëher dhe këtë vendim ajo duhet ta zbattoj, prandaj mendoj që të intensifiokhen kjo qështje të ketë takime edhe me kompanin Hidromorava dhe kjo qështje të zgjidhet njëher e pergjithom pasi që është shumë e dhimbshme që uja ka pompat janë,

sistemi është në të gjitha fshatrat jo vetëm në Llabjan por për neglizhencë të Kompanisë mbesin qytetarët pa ujë, ju faleminderit.

Ramush Mehmeti tha: unë e kam një propozim konkret mendoj se Kuvendi Komunal në këtë seancë të aprovoj një kërkesë për Kompaninë Regjinale Hidromorava që të marrë të gjithë ujësjellast në menaxhim ose të aprovoj një vendim ku të thuhet se kjo kompani ose i marrë të gjithë ujësjellast në menaxhim ose nuk e marrë asnjë, pasi që nuk mundet të bëjë dallim disa ujësjellës të marrë pasi që ka interes të tjerët të mos i marrë, ky është mendimi im, ju faleminderit.

Bajrush Ymeri tha: harrova me thënë se kompania regjinale Hidromorava nuk është kompani fitimprurëse dhe nuk duhet ta shikoj interesin me rritje enkasimin e saj por interesi i saj duhet të jetë qytetarët të furnizohen me ujë pasi që nëse punon me humbje Qeveria e ka për obligim me subvencionu me i mbulu ato humbje për me i furnizuar qytetarët me ujë pasi që uji është prioritet.

Shefkije Mehmeti tha: ne kemi pasur takim edhe me asociacionin e Komunave lidhur me marrëveshjet e Hidromoravës me Komunën, unë e kam ngritur çështjen se si është gjendja e ujësjellësve në Kosovë i kam thënë edhe zyrës zvicerane e cila ka dhënë mjete për këta ujësjellës dhe i kam thënë se ju keni dhënë parë por Hidromorava nuk ka bërë asgjë.

Dobrivoje Džorjević tha: unë e kam një propozim për fshatin Stanishor pasi që nuk ak fare ujësjellës kishte qenë mirë ta ftoj Hidromoravën në mbledhje dhe të na njoftoj se a ka ndonjë plan pasi që ne po bisedojmë por nuk e dim se a ka ndonjë plan kjo kompani apo jo.

Kryesusi tha: të bëjmë një vendim që për ndonjë nga mbledhjet e ardhshme të ftoj përfaqësuesit e Hidromoravës që të na njoftojnë më shumë në lidhje me këtë.

Pika e gjashtë: Informatë rreth mos mirëmbajtjes dhe funksionalizimit të të gjithë shteteve të ndriqimit publik egzistues në Komunën e Novobardës;

Për këtë pikë Kryesusi ja dha fjalën D.SH.P Shefkije Mehmeti.

Shefkije Mehmeti tha: funksionimi i ndriqimit publik përveç në fshatin Bosatn në tjerat fshatra në asnjë nuk punon, zyra e prokurimit e ka shpallur në tender dhe e ka përzgjedhur kompaninë, procedurat veç kanë perfunduar javën e ardhshme veç se do të nënshkruhet kontrata me kompaninë cila do të marrë në menaxhim ndriqimin publik.

Kryesuesi e hapi diskutimin për këtë pikë.

Mirjana Simijonović tha: më vjen mirë pasi që javën e kaluar i kemi parë kamionët duke e rregulluar ndriqimin kanë filluar të punojnë por perseri është nderpre, po bisedohet se qytetarët e Komunës nuk kanë ndriqim por në fshatin Koretisht kur do të ketë ndriqim publik?.

Shefkije Mehmeti tha: thashë edhe më heret se tenderi u shpall që të përzgjedhet kompania për mirëmbajtje të ndriqimit pasi të nënshkruhet marrëveshja të gjithë ndriqimet publike do të menaxhohen dhe mirëmbahen.

Xhijlane Behlulu tha: e kam një pyetje pasi që siç e din me buxhet është votuar ndriqimi publik në fshatin Pasjak, më vjen mirë që në fshatin Koretisht paska filluar por në fshatin Pasjak a është në plan pasi që sa vite nuk është bërë asnjë investim andaj po pyes se a është në plan ndriqimi publik në fshatin Pasjak?.

Shefkije Mehmeti tha: kërkesat janë të shumta dhe e di se ka hyrë në buxhet ky propozim në planet për ndriqimet publike por a ndërtohen këtë vit apo jo nuk e di.

Abdyl Gashi tha: mendoj se ky ndriqim i cili nuk funksionon fare është bërë si monotoni, prapë po e cekim pasi që ka shumë hargjime shumë investime e donacione por projektet pa mirëmbajtje janë të deshtuara, rastet e fundit që kemi degjuar kanë filluar me i vjedh kabllat elektrike, nuk e di pse nuk funksionalizohen pasi që ka shumë hargjime në darka, dreka e keqpërdorime tjera andaj mendoj se dikush duhet me dhënë përgjegjësi morale të pakten pasi që investimet janë të mëdha.

Jorgovanka Filic pasi pershendeti të pranishmit tha: sido që të jetë me të vertet jemi të diskriminuar pasi që secili po bisedon për fshatin e vet por pjesa poshtë Bostanit qytetarët as nuk kanë ndriqim por askush nuk e kërkon pasi që nuk kanë as rrugë. Ejani të shihni se ku jetojmë ne se ku është fshati Jasenovik, Bolevc e fshatrat tjerë afër, ka në familje që i kanë ka 7-8 njerz të palevizshëm.

Kryesusi tha: Kufca është fshati më i madhë dhe ka probleme me infrastrukturë, nuk ka rrugë, nuk ka ujë as unë ku jetoj.

Dobrivoje Djordjevic tha: fillimisht më erdh mirë se kanë filluar punimet e ndriqimit në fshatin Koretishtë, e përkari kolegen se edhe në fshatin Jasenovik duhet të rregullohet ndriqimi.

Mirjana Simijonovic tha: pajtohem me kolegen për fshatin jasenovik, është e vertet se Komuna e Novobërdës është me teritor të madhë por në shekullin 21 të jetohej pa ndriqim, pa ujë, pa rrym, më vjen mirë që të gjithë jemi aktiv pasi jemi prekur të gjitha në këtë pikë pasi që të gjithë po kemi problemet e njejtë.

Zymer Zymeri tha: unë jamë që disa vite këtu dhe fshtrat e mëdha duhet të kenë çdo herë prioritet së pari, kurr nuk kam thënë që të ndertohet diçka të unë por ku është populli aty të ketë edhe investime.

Shefkije Mhemti tha: fshatrat e mëdha i kanë infrastrukturën rrugore si Llabjani dhe Pasjaki e nuk po i përmendeni fshatrat e vogla që mos të shpengulen si fshati Makresh që është pa rrugë dhe fshatrat Bolec që i përmendeni Jorogovanka.

Xhejlane Behluli tha: është shumë e vertet që Pasjaki i vjetër rrugën e ka e kushtet i ka pasi që foli kolegja se kushtet mungojnë në ato fshatra por të lagjaj ku kanë qenë mbeturinat që lagjaj posht rruga dhe gjethëçka ju mungon por ka disa vite që nuk ka asnjë investim as në Pasjakin e vjetër, edhe në Pasjakin e ri ka shumë shumë nevojë për investim.

Ramush Mehmeti tha: me të vertet ke një diskutim shumë i mirë fatkeqësisht nuk ka pas kush me ndëgjuar pasi që ata që duhet të ndëgjojnë nuk janë, si duke Shefkija nuk ka Drejtoresh por zv Kryetare pasi që po jep përgjegjësi, por një gjë po ta kujtoj se në vitin e kaluar në rishikim të buxhetit kemi ndarë një buxhet për ndriqim në Pasjak dhe bëj pyetje se a është rregullu ai projekt. Kuvendi ka marrë vendim për atë listë të projekteve.

Zymer Zymeri tha: Komuna e Novobërdës nuk ka lluk që në fshatin Maresh për 3 shtepi të asfaltoj rrugë në vlerë prej 500,000€, Novobërda ka filluar me u shpengul pasi që shumica kanë dalë në Llabjan, ku ka popull shumë të shkojnë projektet.

Abdyl Gashi tha: më vjen mirë që diskutim për dy pika që janë qensore për të gjithë, shumica u pajtun pasi që i kemi pasur problemet e njeta, janë degjimet publike që ishte dashur të shfrytëzojnë qytetarët por ata nuk po mundë ta marrin pjesë dhe të dhëjnë kontribut pasi që mbahen në sallë të Kuvendit, besoj se në të ardhmen të mendohet më sinqerisht e jo vetëm për qeverisje që Kryetari i Komunës ta shohë asamblenë vetëm si jashtë qeverisjes ku ne duhet të krijojmë nifra përgjegjësi që ai të na raportojë për çdo projekt.

Bajrush Ymeri tha: ju kisha sugjeruar pasi që në kemi aprovuar një plan për investime në ndriqime publike dhe aty shkruan se cilat do të ndertohen dhe cilat do të funksionalizohen poashtu me buxhet të këtij viti janë propozuar edhe disa ndriqime publike të reja të ndertohen, edhe Shefkija e përmendi se projekti është duke u perfunduar për mirëmbajtje të ndriqimeve publike aty ku ka nevojë, ti shikojmë këto mundësi që janë duke u realizuar dhe besoj që gjendja ka me u përmirësuar.

Pika e shtatë: të ndryshme;

Kryesusi e hap diskutimin për këtë pikë.

Xhejlane Behluli tha: e kemi pasur një takim më një organizatë nga Kamenica, edhe aty e takuam Nënkryetarin e Komunës së Kamenices dhe nuk e di nëse kishim pas mundësi me buxhet të Komunës të shkojmë dhe ta vizitojmë Komunën e Kamenices që ti shkëmbejmë përvojat ne si Kuvend dhe të diskutojmë rreth komisioneve se si punojnë ata pasi që mua më intereson komisioni i tatimit në pronë me marrë model në Komuna tjera, nëse është mundësia prej Komunës me na financuar nëse jo shkojmë edhe në mënyrë individuale të bëjmë një vizitë, nëse pajtoheni edhe ju koleg/e.

Kryesusi tha: është ide e mirë, sa i përket buxhetit Kuvendit i ka 7,000 € nga granditë qeveritare, por këtë muaj kemi pasur disa shpenzime të pa planifikuara pasi që përmbaruesi i ka marrë disa mjete ku kanë qenë të lira dhe i ka marrë nga kodi ynë, ne me buxhet të zyres tonë i paguajmë mbushjet, ujë kafe për mbledhje.

Procesverbali i Kuvendit

Bajrush Ymeri tha: po nderlidhem me at diskutimin më heret pasi që unë e kam për të mirën tane pasi nuk po du me të lënë me gabu, shikoje mirë pasi që një pikë kalon njëher në KPF a duhet të kthehet edhe njëher në KPF apo drejt në Kuvend, ju faleminderit.

Naser Ibrahim Menaxher i kompanis regjionale Hidromorava tha: po ju lus si koleg pasi që në muajin e kaluar i kemid erguar rreth 50 klient te permabruesi, andaj ju kerkoj nga ju aty ku jetoni qe ti lusni të pauajn pasi që nuk po i kryejn pagesat me kohe dhe me permabrues duhet 170 € më shumë të paguajn.

Abdyl Gashi tha: e kam një kerkes si asmableist të shikohet mundësia e buxhetit të Kuvendit të rregullohen tavolinat e sallesa së Kuvendit pasi që nuk po kemi mundësi ku ti vendosim të gjithë dokumentet.

Zymer Zymeri tha: zt.Kryesus si është e mundur që vetem 250 € te jene buxhet i Kuvendit, duhet të ruhet buxheti i Kuvendit mos të barten në kode tjera pasi që mundë të keni ndonjë delegacin e si do ti pritni, dhe ne mundë të rrezikohemi edhe për paga, paret e Kuvendit janë të Kuvendit.

Milica Jovanovic tha: unë për këtë mbledhej nuk e kam marrë materialin as kopje fizike as eelektornike dhe procesverbalet e KPF-së tetor dhe nentor në gjuhen serbe nuk i kemi marrë ende.

Kryesusi tha: e dini se nga fillimi Kuvendi nuk ak vetur për dergim të materialeve andaj kemi problem me dergimin e materialeve, sa i perket procesit të KPF-së ne gjuhen erbe do të kryhet për mbledhjet e ardhshme.

Pasi nuk pat diskutime tjera Kryesuesi i falenderoi të pranishmit për pjesëmarrje.
Mbledhja përfundoi në ora 12:20.

Valmire Mustafa
Procesmbajtëse



Nebojsa Arsic
Kryesues i Kuvendit

